



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 22.09.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Rita Zeqiri (VV), Gresa Lahu (PDK), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

Të pranishëm ishin edhe: Granit Rugova, drejtor në Drejtorinë e Sportit dhe Hyzdri Bunjaku, përfaqësues i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Valbona Ajeti**, kryesuese e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për mbledhje propozoi këtë

REND TË DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 2. Diskutim për subvencionet për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;**
- 3. Plani i punës së Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesja, konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pika e dytë

Diskutim për subvencionet për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Granit Rugova, drejtor tha se ne paraprakisht me Endrit Zabërgjen kemi diskutuar në përgjithësi si funksionon puna e subvencioneve, cilat janë prioritetet për subvencione. Për këtë çështje më në detaje rreth subvencioneve do të diskutoi Hyzdri Bunjaku, përfaqësues i Drejtorisë së Sportit.

Hyzdri Bunjaku, tha se drejtorja i ka pasur në fakt një shumë prej 800 mijë euro për subvencione të cilat janë ndarë realisht edhe për sport dhe rini. Ky lloj subvencionimi ka filluar vitin e kaluar dhe ka vazhduar edhe sivjet që janë në fakt bursat për shpresat e sportit në shumën prej 20 mijë euro, përkatësisht nga 1 mijë euro për bursist, ata që i fitojnë. Për ndarjen e këtyre bursave ka pasur kriteret të përgjithshme të përgjegjësve dhe të veçanta që janë përfshirë realisht për përfituesin, të cilët kanë qenë meritoret.

Edhe tek subvencionet si të ato të zakonshme ose të përgjithshme që jepen edhe për klubet sportive edhe për OJQ- të, rinore.

Si drejtori kemi bërë sigurisht edhe vizita edhe tek klubet sportive dhe tek OJQ- të, në realizimin e projekteve që i kanë paraparë dhe si komision e kemi bërë punën në fakt gjithmonë duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat i kemi të përcaktuara. Jemi të kënaqur realisht me punën që e bëjmë, por asnjëherë mos të ndalemi në atë pjesën të cilën ne mund të japim kontribut ose ata mund ta bëjnë punën e tyre sa i përket qoftë mbështetjes që e kanë ose punës që mund ta bëjmë të përditshme.

Rita Zeqiri, kërkoi të dijë se përfituesit e subvencioneve, bursistët, a duhet të sjellin arsyeshmëri ose fatura të shpenzimit apo jo.

Hyzri Bunjaku, tha se sipas rregullores kjo është bursë, në fakt nuk është e arsyeshme për të sjell dëshmi. Ato mjete janë shpenzuar për nevojat e tyre si p.sh blerja e një biçiklete profesionale ose diçka tjetër që ju ka nevojitur shumë në profesionin që ata realisht veç e bëjnë.

Rita Zeqiri, po ashtu tha se a do të kishte mundësi që ky lloj subvencionimi të rritet dhe të jetë 30 mijë euro.

Endrit Zabërgja, tha se cilat kanë qenë kriteret aktuale ose cila ka qenë forma e vlerësimit që është bërë për mbështetjen e subvencioneve të ndryshme, a ka ekzistuar ajo qasje që me tentuar për t'i subvencionuar të gjitha nga pak, apo i keni pasur kriteret e veçanta në mënyrën e asaj që edhe nëse kanë përfituar pak organizata bile ato që kanë përfituar me qenë të duhurat.

Po ashtu kërkoi të dijë se si është bërë monitorimi deri më tash në kuadër të këtyre OJQ-ve, si është bërë mbikëqyrja e këtyre fondeve dhe a ekziston mundësia potenciale ose ligjore e ndryshimit të formës të subvencioneve të rinisë, përveç financimit të OJQ-ve, ndarja e këtij fondi i destinuar për rini dhe tek përfituesit individual në këtë rast siç janë bursat për shpresat

Hyzdri Bunjaku, tha se çka mundet me qenë kyçe dhe që vlerësohet prej komisioneve është tek kriteret e përzgjedhjes, pra janë marrë shumë kriteret të cilat janë të përcaktueshme fillimisht janë realisht kriteret se kush është përfitues do me thënë kush është përfitues prej këtij projekti, sa është gama e gjerë e përfituesve qoftë të rinjë, qoftë njerëz të cilët janë realisht grupe të marginalizuara ose diçka tjetër. Janë marrë si kriter tek përkrahja realisht ata të cilët kanë dhe bashkëpunime të ndryshme shembull me organizata të tjera të ndryshme.

Endrit Zabërgja, tha se cilat janë tematikat kryesore të cilat janë përzgjedhur që të subvencionohen.

Hyzdri Bunjaku, tha se tematikat kryesore kanë të bëjnë ndoshta me idetë me të cilat janë marrë që janë paraqitur me përfshirjen e të rinjve, ka pasur edhe grupe të marginalizuara të cilat kanë qenë, realisht janë përkrahur p.sh OJQ-të, të cilat merren ekskluzivisht me Syndrom Down që mund të bëjnë projekte sportive ose shoqata e të verbërve etj.

Granit Rugova, drejtor tha se shumica e mjeteve buxhetore prej 800 mijë euro realisht nuk janë pak mjete, por kur të ndahet në 200 e më tepër kërkesa mbeten pak mjete, kështu që nuk mund të presim rezultate kulminante, sepse ato janë më shumë fonde sa për të funksionuar.

Duke pasur parasysh këtë, ne jemi munduar t'i përkrahim pak më shumë garuesit në arenat ndërkombëtare, si dhe ato klube të cilat merren me masivizim me vajza, po ashtu kemi edhe një numër të klubeve cilët nuk janë përkrahur fare.

Do të ishte mirë që bashkërisht ta diskutojmë dhe të shihet mundësia e përkrahjes së të rinjve, mendojmë që është më mirë të shkojmë masivizim do me thënë sa më shumë të ri, fëmijë me i sjell tek sporti.

Rita Zeqiri, tha se a ka ndonjë linjë të veçantë buxhetore për ndonjë projekt që mendohet të zhvillohet në muajt e ardhshëm si p.sh në dhjetor një klub po dëshiron të organizoj një garë të caktuar e që nuk e kanë paraparë më herët tash e kanë parapa rrethanat etj, dhe a ka ndonjë mënyre si mbështeten këto klube. Po ashtu tha se a mund të përkrahët dy herë një klub por jo për të njëjtin, por për projekte të ndryshme, në fazën e parë e ka një projekt për masivizim fazën e dytë e ka një projekt diçka tjetër, ju lejohet apo nuk ju lejohet.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Zeqiri, sqarime shtesë dhanë Granit Rugova, drejtor dhe Hyzdri Bunjaku, përfaqësues i drejtorisë.

Adelina Mehiu, kërkoi të dijë se përfituesit e bursave a janë më shumë meshkuj apo femra, a ka ndonjë barazi gjinore, apo merren për bazë kriteret të cilat ju i përcaktoni.

Hyzdri Rugova, drejtor tha se nuk ka ndonjë kusht që e përcakton përfituesin e bursave.

Pika e tretë

Plani i punës së Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Kryesuesja, tha se në mbledhjen e parë dhe të dytë e kemi diskutuar që bashkërisht do të bëjmë planin e punës, por në bashkëpunim edhe me drejtorët e drejtorive përkatëse. Me një plan të punës kishte me qenë më e lehtë edhe si komitet të funksionojmë, por edhe do të kishim ditur për çka të thirremi, kështu që e gjitha kjo është në bashkëpunim me dy drejtorët për ato pika që do ti diskutojmë.

Granit Rugova, drejtor tha se çdo aktivitet që është mbajtur në Prishtinë përveç që është përkrahur financiarisht edhe me diçka tjetër është ndihmuar qoftë në organizim, qoftë me rrethoja, me sigurim, qoftë në promovim do me thënë çdo aktivitet i mundshëm në Prishtinë që u bë nga Drejtoria e Sportit dhe të tjerët në një formë ose tjetrën e kanë ndihmuar atë, kështu që nuk ka qenë vetëm forma financiare por i kemi përkrah edhe me forma të ndryshme.

Kryesuesja, tha se në planin e punës duhet të parashihen tema të ndryshme që për muajt e radhës të jenë në diskutim, kështu që me plan dihet se çka do të punojmë dhe mendoj se do ta kemi më lehtë.

Rita Zeqiri, tha se është një kalendar i eventeve sportive, por ne nuk kemi ndonjë organizim të tillë. Një kalendar i tillë ekziston si p.sh në Tiranë, ku janë disa evente sportive të cilat edhe vet kam qenë pjesë. Mendoj se ka edhe aktivitete të tjera e që ne ata aktivist paraprakisht mund t'i ftojme, pra me e caktuar kalendarin dhe ta promovojmë.

Hyzri Bunjaku, tha se është mirë me e pas një takim me federatat, sepse federatat i parashohin organizimet që janë në nivel komunal ose vendor.

Rita Zeqiri, tha se ka shumë sporte që janë jashtë federatave, bëjnë organizim si p.sh. noti.

Granit Rugova, drejtor tha se këtë ne mund ta bëjmë si njoftim ose thirrje gjitha klubeve, ose aktiviteteve të OJQ-ve, të na dërgojnë kalendarin e aktiviteteve që i kanë mbajtur deri më tash dhe që mendojnë t'i mbajnë të paktën për vitin 2023.

Rita Zeqiri, tha se në not është një garë që është ndërkombëtare, pra ne e kemi edhe gjysmë maratonën e Prishtinës, pra kemi aktivitete të tjera dhe ti promovojmë dhe ti bëjmë kështu ngjarje të rëndësishme së veçantë. Pse me kaluar gjysmë maratona e Prishtinës pa e ditur askush që është mbajtur.

Endrit Zabërgja, kërkoi të dijë nga drejtori se a ekziston plani i punës i Drejtorisë së Sportit për vitin 2023, kështu që nëse është hartuar një plan i tillë ne si komitet mund të ja përshtatmi planin e punës sonë, krahas planit të punës së drejtorive.

Kryesuesja, tha se ne edhe më herët kemi diskutuar për planin e punës së komitetit, por pajtohemi me parafolësit se, pa e pasur edhe planin e drejtorive përkatëse, ne nuk e dimë se çka do të ketë në sport, në kulturë dhe rini. Presim që në mbledhjen e radhës të paktën ta kemi draft planin e drejtorisë.

Granit Rugova, drejtor tha se deri në fund të vitit e bëjmë këtë plan, sepse ai plan na duhet edhe neve si drejtori, po ashtu do të jetë i hapur edhe për komitetin.

Kryesuesja, tha se ne do të presim deri sa të na sillen planet e punës së drejtorive përkatëse dhe ne pastaj i qasemi hartimit të planit të punës së komitetit.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesuesja e mbledhjes së komitetit
Valbona Ajeti



Faqe5nga5